



**Numri:** KSC-CC-2019-07

**Vendosi:** **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**  
Gjykatës Vidar Stensland, Kryetar i panelit  
Gjykatës Roland Dekers  
Gjykatës Antonio Balsamo

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 11 dhjetor 2019

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

**Në vëmendje të:** **Parashtruesit**  
Driton Lajçi

### Njoftim në lidhje me parashtrimin e kundërpërgjigjes

1. Më 14 nëntor 2019, z. Driton Lajçi i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese një kërkesë referuese që mban datën 13 nëntor 2019 ("Kërkesa Referuese"),<sup>1</sup> në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në kërkesën referuese parashtruesi paraqiti ankesë mbi fletëthirrjen dhe procedurën e marrjes në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS).
2. Duke mbajtur parasysh se kërkesa referuese ka të bëjë me sjelljen dhe veprimet e ZPS-së, më 18 nëntor 2019 paneli e lejoi Prokurorin e Specializuar që, në rast se dëshironte, mund të paraqiste përgjigje ndaj kërkesës referuese.<sup>2</sup> Më 2 dhjetor 2019,

<sup>1</sup> KSC-CC-2019-07, F00001, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ligjshmërinë e procedurës së marrjes në pyetje, publike me shtojca konfidenciale, 13 nëntor 2019.

<sup>2</sup> KSC-CC-2019-07, F00006, Njoftim në lidhje me parashtrimin e kundërpërgjigjes, publik, 18 nëntor 2019.

ZPS-ja dorëzoi përgjigjen ndaj kërkesës referuese<sup>3</sup>, në lidhje me të cilën parashtruesi paraqiti kundërpërgjigjen e tij më 9 dhjetor 2019.<sup>4</sup> Në kërkesën e ZPS-së që aktualisht shqyrton paneli, ZPS-ja kërkon që, ose paneli të mos e marrë në shqyrtim kundërpërgjigjen e parashtruesit të 9 dhjetorit 2019, ose të lejojë ZPS-në që t'i kthejë përgjigje asaj.<sup>5</sup>

3. Paneli e lejon ZPS-në që t'i kthejë përgjigje kundërpërgjigjes së parashtruesit të 9 dhjetorit 2019 (KSC-CC-2019-07, F00009). ZPS-ja lejohet të parashtojë përgjigje vetëm në lidhje me përmbajtjen e kundërpërgjigjes së parashtruesit të 9 dhjetorit 2019 (KSC-CC-2019-07, F00009) dhe nuk lejohet të ngrejë çështje faktike ose ligjore të reja. Paneli nuk do të marrë në shqyrtim asnjë parashtrim që del jashtë kësaj kornize. Përgjigja duhet të parashtrohet **më 17 dhjetor 2019, ose para kësaj date.**

/nënshkrimi/

**Gjykatës Vidar Stensland**

**Kryetar i panelit**

Hartuar në anglishte, e mërkurë, 11 dhjetor 2019

Në Hagë, Holandë

---

<sup>3</sup> KSC-CC-2019-07, F00008, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës Referuese të z. Driton Lajçi drejtuar panelit të Gjykatës Kushtetuese mbi ligjshmërinë e procedurës së marrjes në pyetje me shtojcat konfidenciale 1-3, publike me shtojcat konfidenciale, 2 dhjetor 2019.

<sup>4</sup> KSC-CC-2019-07, F00009, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar Gjykatës Kushtetuese, publik, 9 dhjetor 2019.

<sup>5</sup> KSC-CC-2019-07, F00010, Kërkesë e Prokurorisë për autorizim për t'i kthyer përgjigje parashtrimit të protokolluar KSC-CC-2019-07/F00009, publik, 10 dhjetor 2019.